



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2, nenin 103.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendimin e KQZ-së nr.1845/2019, të datës 27.11.2019 për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura 06 tetor 2019, si dhe vendimin KQZ-së Nr.979/20200, të datës 27.10.2020, për ruajtjen e kutive të votimit me material zgjedhor, të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura 06 tetor 2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 10.12.2020, nxjerrë këtë:

## VENDIM

### Për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më datën 06 tetor 2019

I. Miratohet asgjësimi-shkatërrimi i materialit zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 06 tetor 2019, për kutit e votimit të vendvotimeve në të cilët niveli i mospërputhjes rezultatet e votave në FRP dhe FRK, toleranca deri në 50 vota, që nuk tejkalohe pas rinumërimit në QNR, si në vijim:

### II. Materiali zgjedhor i cili do të asgjësohet/shkatërrohet është si vijon:

1. Fletëvotime të vlefshme/të pavlefshme/ të zbrazëta/ të dëmtuara;
2. Kopja dhe origjinali i Formularit të Përputhjes të dhënave dhe Rezultateve (FPR);
3. Lista e Gjerë e votuesve të komunave;
4. Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV) dhe Lista e Votuesve me Kusht (LVK);
5. Librat e Votimit (Ditarët);
6. Fletëvotimet e Papërdorura;
7. Fletëvotimet me Kusht;
8. Vula zyrtare e Fletëvotimit/vulat tjera- vula zyrtare e fletëvotimit pjesa e gomës;

### III. Materiali zgjedhor i cili do të ruhet është si vijon:

1. Pakot e votimit-nga një (1) pako e votimit me material të papërdorur zgjedhor do të ruhet për qëllime trajnimi;
2. Vula zyrtare e Fletëvotimit/vulat tjera- pjesa e drurit do të ruhet për përdorim në të ardhmen;
3. Dosjet e Formularëve të Rezultateve;
4. Zarfet e Bardhë të Fletëvotimeve me Kusht te paplotësuara;

5. *Zarfet e Fshehtësisë të Papërdorur;*
- IV. Komisioni i përbërë nga Sekretariati, para se të asgjësohet/shkatërrohet materiali si në pikën I dhe II të këtij vendimi, do të bëjë një analizë të fletvotimeve të pavlefshme, dhe do të marrë për bazë 10% të fletvotimeve të pavlefshme për secilën komunë, sipas “Metodologjisë për Hetimin e Fletvotimeve të Pavlefshme”.
- V. Materiali zgjedhor që është objekt i hetimeve të Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP) përjashtohen nga asgjësimi/shkatërrimi, sipas vendimit të KQZ-së Nr.979/20200, të datës 27.10.2020, për ruajtjen e kutive të votimit me material zgjedhor, të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura 06 tetor 2019, dhe listës së materialeve zgjedhore të dorëzuara në KQZ, janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.
- VI. Lista e vendvotimeve për shkatërrimin e materialeve zgjedhore, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- VII. I gjithë materiali që është për t’u asgjësuar/shkatërruar dhe ruajtur i specifikuar në pikën II dhe III të këtij vendimi do të asgjësohet/shkatërrohet dhe ruhet nën mbikëqyrjen e Komisionit të caktuar nga SKQZ-ja për këtë qëllim.
- VIII. Obligohet Sekretariati që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi brenda afateve të përcaktuara ligjore.
- XI. Ky vendim hyn në fuqi me 10.12.2020.

Prishtinë, 10.12.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

